



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:001759

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05839352

**2024:019495**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.S me vendbanim në fshatin N.E Komuna Ferizaj, për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 367 par.1 të KPRK-ës dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.1438/23 e datës 16 Janar 2024, pas mbajtjes së seancës mbi shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë me datë 12 Qershor 2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ibadete Hamiti, të akuzuarit me mbrojtësin me autorizim av.Samir Rekaj, të njëjtën ditë shpalli dhe komunikoi ndërsa me datë 20 Qershor 2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I. I.S, i lindur me ...**, nga babai N. dhe nëna Z., e vajzërisë H., me vendbanim në fshatin N. E, Ferizaj, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme,punëtor fizik, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri, me numër personal ...

## S E P S E

### I

Nga data e pa vërtetuar e deri më datën 28 korrik të vitit 2023, në fshatin N.E Komuna Ferizaj, saktësisht në shtëpinë e tij, i akuzuari në kundërshtim me Ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, ka mbajtur në posedim pa leje dhe pa autorizim përkatës një pistoletë me gaz e tipit “Zoraki”, kalibri 9mm, me numër serik ...359, me një karikator dhe (5) pesë fishek, e cila armë i është sekuestruar nga ana e policisë, dhe këtë armë e kishte mbajtur pa pasur leje nga organi kompetent.

**- me të cilin veprim ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës**

### II

Më datën 28 korrik të vitit 2023, në fshatin G., Komuna Ferizaj, i akuzuari në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr.05/L-022, me dashje përdor armën me gaz të tipit “Zoraki” kalibri 9mm, me numër serik ....359, në atë mënyrë që gjatë një ahengu familjar, në shenjë gëzimi me të njëjtën shtën tre herë në ajër, ku edhe më pas arma në fjalë i sekuestrohet si provë materiale nga ana e policisë.

**- me të cilin veprim ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-ës**

**Andaj, Gjykata në bazë dhe neneve 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 37, 38, 39, 40, 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-ës, dhe nenit 230 dhe 364 të KPPK-ës, të akuzuarin, i**

## G J Y K O N

**Për pikën një të dispozitivit** (veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-ës) dënim me gjobë në shumë prej 400 euro.

**Për pikën një të dispozitivit** (veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-ës), denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili denim në bazë

të nenit 44 të KPRK-ës dhe me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me denim me gjobë në shumë prej 600 € /gjashtëqind euro/.

Gjykata në bazë të dispozitës ligjore neni 76 të KPRK-së, të akuzuarin e.

### **GJYKON ME DENIM UNIK**

Dënim me gjobë në shumë prej 1000 /një mijë/ euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, të njejtat do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do ti llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

Në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-ës, konfiskohen në mënyrë të përhershme pistoleta e modelit Zoraki, kalibër 9 mm, me numër serik ....359, një karikator me 5 copë fishekë, dhe 3 gëzhoja.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /euro, si dhe në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

### **A r s y e t i m**

#### **Historiku procedural**

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit I.S me vendbanim në fshatin N.E Komuna Ferizaj, për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 367 par.1 të KPRK-ës, dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.1438/23 e datës 16.01.2024, ku së bashku me aktakuzën ka pranuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë e nënshkruar nga ana e të

akuzuarit me avokatin e tij mbrojtës, prokurori i shtetit dhe kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj Shukri Jashari.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar sipas kësaj aktakuze dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datën 12 Qershor 2024, ka mbajtur seancën lidhur me shqyrtimit të marrëveshjes, në të cilën i akuzuari dhe mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe duke i propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

### **Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë**

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjyqtarja konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 230 par. 18 të KPP-ës:

- i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë Deklaratat e të akuzuarit I.S të dhënë para prokurorit të shtetit më datë 11.01.2024, Raporti i Oficerit A.H me numër 2023-CF-1596, i dt.29.07.2023, Vërtetimi për konfiskimin e armatimit dhe municionit nr. 2023-CF-1596; i datës 29.07.2023, Zingjiri i ruajtjes më numër 2023-CF-1596, datë 29.07.2023, Dy fotografi në një format A4, të bëra armës së sekuestruar tek i akuzuari I.S, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

Andaj, me aktvendim pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

### **Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit**

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjyqtarja gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive e veprave penale që e ngarkon aktakuza meqë me datë, kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari ka mbajtur në posedim pa leje dhe pa autorizim përkatës një pistoletë me gaz e tipit “Zoraki”, calibri 9mm, me numër serik .....359, me një karikator dhe (5) pesë fishek, e cila armë i është sekuestruar nga ana

e policisë, dhe këtë armë e kishte mbajtur pa pasur leje nga organi kompetent si dhe me datë 28 korrik 2023 në fshatin G..., K. Ferizaj me dashje përdor armën me gaz të tipit “Zoraki” kalibri 9mm, me numër serik .....359, në atë mënyrë që gjatë një ahengu familjar, në shenjë gëzimi me të njëjtën shtën tre herë në ajër, ku edhe më pas arma në fjalë i sekuestrohet si provë materiale nga ana e policisë për të cilat veprime i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, edhe sa i përket veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 në aspektin juridik, gjyqtarja gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale që e ngarkon aktakuza meqë me datë, kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armë, me dashje ka përdorur armën me gaz e tipit “Zoraki”, kalibri 9mm, me numër serik .....359, në atë mënyrë që gjatë një ahengu familjar, në shenjë gëzimi me të njëjtën shtën tre herë në ajër, ku edhe më pas arma në fjalë i sekuestrohet si provë materiale nga ana e policisë për të cilat veprime i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Vlerësimi për dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe gjeti se si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë përmesë marrëveshjes për pranim fajësie, pendimin e shprehur lidhur me kryerjen e veprës penale nga ana e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, hera e parë që bie ndesh me ligjin, se i akuzuari edhe në marrëveshje për pranimin e fajësisë edhe në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim duke kërkuar falje për veprimet e tij, ndërsa si rrethana rënduese vlerësoi që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale nga kryerësi i cili duke mos e përfillur vendimin e organeve kompetente dhe ndërtimin e objektit pa leje ndërtimore ku pas ndaljes së punimeve i njëjti i heq shenjat dhe shiritat zyrtar dhe vazhdon punimet.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin

se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

### **Shpenzimet procedurale**

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti Përgjithshëm Penal,**

**2024:019495 i datës 20 Qershor 2024**

**Praktikante,**

Elmedina Hakiu

**Gjyqtarja,**

Mimoza SHABANI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.